



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.14

Prishtinë, më 22.05.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,  
KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Në mbledhje morën pjesë:** Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu, Serdjan Popovic.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Dagmar Fuchs Schmitz-GIZ, Sokol Elshani-GIZ, Blerta Zogiani-GIZ, Blendina Krasniqi- UNDP (praktikante).

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi Salih Morina, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend dite:**

- Miratimi i rendit të dits;
- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.04.2015;
- Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ .
- Të ndryshme.

Zëvendëskryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 29.04.2015, u miratua pa vërejtje.

## 3. Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ

**Salih Morina**, tha se qëllimi i këtij takimi është që bashkarisht me përfaqësuesit e GIZ-it të punojmë në agjendën e vizitës që do të bëjë Komisioni në Gjermani mbështetur nga GIZ-i. Ai tha se nga vizitat zyrtare të më parëshme kemi përfituar shumë dhe kërkoi nga përfaqësuesit e GIZ-it që të prezentojnë agjendën dhe pastaj bashkarisht me të gjithë anëtarët e Komisionit të dakordohen për objektivat kryesore të kësaj vizite.

**Dagmar Fuchs Schmitz**, tha se edukimi është moto për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe kjo është arsyeja pse Gjermania mbështet reformat e arsimit në Kosovë dhe ju si anëtarë të Komisionit për Arsim keni përgjegjësi që të mbështesni Ministrinë në gjetjen e politikave të duhura për të zhvilluar edukimin. Ajo propozoi që Komisioni në këtë udhëtim të vizitoi Bundenstagun Gjerman, Këshillin Federal të Shtetit, Komisionet dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që secili të formojë nga tri pyetje, përgjigjet e të cilave do të dëshironin ti mësoni në këtë vizitë. Në vazhdim theksoi se jemi të vendosur që kjo vizitë të shpërblehet dhe të jetë diçka që ju përshtatet dhe që ju nevojitet këtu.

**Sokol Elshani**, tha se pyetjet e anëtarëve të Komisionit janë këto: 1. Si funksionon arsimi i lartë dhe a ka ndikim Ministria përkatëse në politikën e arsimit të lartë; 2. A përdoren në mësimdhënje teknikat që ndihmojnë mësimdhënjen bashkohore; 3. Si funksionon sistemi arsimor në shkollat profesionale dhe si realizohet lidhja me bizneset; 4. Cili është roli i Komisionit Parlamentar për arsim në politikën edukative në Gjermani dhe roli i Akademisë së Shkencave; 5. Etapat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsim në tri nivelet e arsimit; 6. Si funksionon sistemi arsimor nga edukimi fillor deri te zgjedhja e anëtarëve të Akademisë së Shkencave; 7. Si është e organizuar matura në Gjermani; 8. Si bëhet shqyrtimi i projektligjeve për arsim nga ana e Komisionit Parlamentar; 9. Si është i organizuar niveli arsimor universitar dhe format e funksionimit të saj; 10. A kontakton Komisioni i Arsimit me shkollat, nëse po në cilat raste; 11. Cili është funksioni i Agjencionit të Akreditimit; 12. Cilat janë format e kontrollit të Qeversisë nga Ministria e Arsimit; 13. Si zhvillohen politikën e arsimit parauniversitar; 14. Cilat janë përgjegjësitë e Komisionit të Arsimit; 15. Arsimi privat si zhvillohet; 16. Sfidat në arsimin e mesëm profesional; 17. Rregullimi legjislativ i arsimit në të gjitha nivelet; 18. Matura shtetërore; 19. Si mirren iniciativat për ndonjë reformë në arsim; 20. Si funksionon sistemi arsimor në Gjermani;

**Dagmar Fuchs Schmitz**, tha se jam shumë e lumtur që e zhvilluam këtë lloj ushtrimi dhe do të ishte mirë që gjatë vizitës të kemi sesione brenda javës ku ju mund të parashtroni pyetje politike dhe pyetje të tjera në nivel nacional dhe në nivel senati. Ajo theksoi se kolegët në Gjermani kanë sygjerruar të vizitoni Parlamentin Gjerman, Këshillin Federal, Komisioni për Edukim, Qeverin në

Berlin, një Komision të Edukimit dhe ekspertët e arsimit për të diskutuar për çështjen e maturës në Gjermani. Ajo tha se është me rëndësi që të nxjerrim më të mirën nga secili takim dhe do ishte mirë që ti ndani përgjegjësit dhe në një takim një anëtarë i Komisionit të merret me një temë.

**Salih Morina**, tha se si Komision para udhëtimit zyrar i ndajmë detyrat dhe përgjegjësitë që kemi, Komisioni përbëhet nga anëtarë të fushave përkatëse në lëmi të arsimit por në parim pajtohem që secili nga anëtarët e Komisionit ta ketë një objektiv lidhur me diskutimin që do ta kemi në agjendë.

**Dagmar Fuchs Schmitz**, tha se do t'iu sygjeroja që të fokusoheni në fushat që janë në planin e punës tuaj për këtë vit dhe në ligjet të cilat do të aprovohen si ai i Maturës, Inspektoriatit dhe Arsimit i Lartë dhe ti takojmë ekspertët e këtyre fushave për të diskutuar se si zhvillohen këto në Gjermani.

**Ismajl Kurteshi**, tha se është me rëndësi të takojmë Komisionin homolog Gjerman, Ministrinë e Arsimit, një Drejtor të Arsimit të një Komune në Gjermani, Inspektoriatin e Arsimit dhe një Institucion ku mund të mësojmë se si funksionon arsimit privat, akreditimi, standardet, rregullat dhe monitorimi.

**Dagmar Fuchs Schmitz**, tha se është e rëndësishme të vizitohet edhe Komisioni për Financa për të parë se si ndahet buxheti për arsim dhe si shpenzohet. Në vazhdim tha se në Gjermani e kemi një sistem të raportimit gjatë monitorimit të ligjit, ku një person i specializuar për mbikëqyrje dhe monitorim në një sektor të caktuar, raporton në Parlament për sektorin përkatës dhe Komisioni për Financa këtu janë duke punuar në këtë drejtim prandaj ndoshta do tu interesonte të shihnit se si funksionon ky Komision që pastaj ju të mund të vendosni nëse dëshironi ta bëni këtë form apo jo.

**Bekim Haxhiu**, tha se interesi ynë nga kjo vizitë është që të marrim sa më shumë informata për sistemin arsimor në Gjermani pasi që është sistem i avancuar dhe që ne e synojmë. Fokusi i vizitës duhet të jetë në bashkëpunimin dhe diskutimin me Komisionin Parlamentar Gjerman për Edukim dhe njohja me monitorimin e cilësisë në arsim dhe monitorimin e kualitetit të mësimdhënjes në sistemin parauniversitar dhe universitar.

**Shpejtim Bulliqi**, tha se këto vizita që janë paraparë do të jenë të mjaftueshme për të marrë informacione të cilat do të jenë shumë të vlefshme për ne.

**Serdjan Popovic**, tha se kam pasur rastin edhe më parë të marrë pjesë në vizita studimore në Gjermani dhe kjo është mundësi e mirë që të marrim më shumë informata për sistemin e edukimit në Gjermani i cila mund të jetë i nevojshme për Kosovën.

**Teuta Haxhiu**, tha se fokusi ynë është në cilësinë në arsim, përkatësisht në Ligjin për Inspektoriatin, në çështjen e shkollimit profesional dhe lidhjen në mes të programeve me

bizneset. Arsimi privat si një brengë në Kosovë, do të ishte në interes të shohim se si funksionon atje.

**Shukrije Bytyqi**, tha se kemi nevojë që të shkëmbejmë përvoja me Gjermaninë e cila ka një sistem shumë të mirë të arsimit. Ajo theksoi se në këtë udhëtim duhet të fokusohemi në tri fusha, arsimin profesional pasi që Kosova synon të rrisë numrin e shkollave profesionale, monitorimin e ligjit dhe akreditimin në sektorin privat edhe publik.

**Dagmar Fuchs Schmitz**, tha se ekipi në Gjermani është duke shiquar se kush është i gatshëm të takohet me ju dhe cilat nga këto pikë mund ti realizojmë por agjenda finale do të vie kur të aprovohet pjesmarrja e të gjithë atyre që është planifikuar ti takoni. Sa i përketë mbështetjes së Komisionit nga GIZ kërkoi nga anëtarët e komisionit të identifikojnë fushat në të cilat kanë nevojë për mbështetje dhe pastaj të shohin se çka janë në gjendje të ofrojnë.

**Salih Morina**, në emër të Komisionit falënderoi GIZ-in për realizimin e kësaj vizite dhe tha se shpersoi që kjo të jetë një vizitë ku do të mund të fitojmë njohuri.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,**

---

**Nait Hasani**